

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

SUBJEKT I MONITORUAR: HAJRIE MUÇMATA, GJYQTARE, GJYKATËS SË APELIT SHKODËR

RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE DATË 09/11/2022 PRANË KPA:

Komisionit i Pavarur i Kualifikimit (KPK), ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit, për kriterin e pasurisë.

Trupa gjyqësore pas marrjes së vendimit të ndërmjetëm në dhomë keshillimi vendosi:

-Të riçelë hetimin gjyqësor dhe dhe pranimin e administrimit të provave të reja të depozituara nga subjekti;

-Rrëzimin e kërkesave në lidhje me pavlefshmërinë absolute të vendimit të KPK

-Refuzimin për pezullimin e këtij gjykimi si dhe realizimin e një analize të re financiare nga KPA

-Të shpallë vendimin përfundimtar më datë 15.11.2022 ora 14:30.

Seanca gjyqësore publike në KPA zhvillohet pa praninë e publikut, por vetëm me praninë e palëve ndërgjyqëse



Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Znj. Hajrie Muçmata, përballet me rivlerësimin e saj në KPA.

Me datë 09.11.2022 ora 11:10, u zhvillua në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA) seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Hajrie Muçmata, Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për shkak të Ankimit të saj ndaj Vendimit Nr. 209 datë 11.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), vendim i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit, bazuar vetëm për kriterin e pasurisë.

KPA ka njoftuar më herët se ka vendosur në dhomë këshillimi, gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike bazuar në nenin 51 pika 1, shkronja b të Ligjit 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Trupi gjykues në çelje të seancës gjyqësore nuk informoi konkretisht se cilat ishin shkeljet e rënda procedurale, mbi vendimin e KPK dhe nuk relatoi çështjen sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Subjekti i rivlerësimit si dhe përfaqësuesi ligjor, morën fjalën duke cituar shkaqet e ankimit ndaj vendimit të KPK.

Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij pretendoi, se: Vendimi i KPK nuk është nënshkruar nga ana e relatorit dhe nuk është arsyetuar nga ana e tij sipas nenit 308 të K.Pr.Civile; Relatori në çështjen e KPK-së ka qenë më herët i shkarkuar nga ish-KLD dhe në kuptim të nenit 107-108 të Kodit të Procedurave Administrative dhe Nenit 123 të K.Pr.Civile, vendimi i KPK është absolutisht i pavlefshëm, duke paralelizuar me vendimin gjyqësor të GJEDNJ "Cani kundër Shqipërisë"; gjithashtu vlerësimi i pasurisë nga ana e KPK është realizuar jo në përputhje me Ligjin Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në fund kërkoi administrimin e provave të reja; çeljen e hetimit gjyqësor dhe kthimin për rigjykim të çështjes.

Trupa gjykuese pas marrjes së vendimit të ndërmjetëm në dhomë këshillimi vendosi:

-Të riçelë hetimin gjyqësor dhe pranimin e administrimit të provave të reja të depozituara nga subjekti;

-Rrëzimin e kërkesave në lidhje me pavlefshmërinë absolute të vendimit të KPK;

-Refuzimin për pezullimin e këtij gjykimi si dhe realizimin e një analize të re financiare nga KPA;

-Të shpallë vendimin përfundimtar më datë 15.11.2022 ora 14:30.

Gjatë gjyqimit të kësaj çështjeje në KPA, vërehet se seanca gjyqësore publike, zhvillohet pa praninë e publikut, por vetëm me praninë e palëve ndërgjyqëse. KPA i mundëson publikut të monitorojë seancën dëgjimore nëpërmjet një paisje audiovizive në korridorin e këtij institucioni. Këto kufizime janë për shkak të mos shfuqizimit të Rregullores së KPA datë 12.06.2020 "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit".

Në optikën e vëzhguesit të KShH-së vërehet se kufizimi i pjesëmarrjes së publikut në seancë gjyqësore publike është në kundërshtim me dispozitat ligjore nr. 65 pika 1 të Ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenit 20 dhe 51 të Ligjit Nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

administrative''. KShH do të analizojë në vijimësi proporcionalitetin e këtij kufizimi dhe do të ketë një qëndrim të pavarur, nëse vlerësohet që elementët e publicitetit janë shkelur në mënyrë joproporcionale.